



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Ne mbështetje e neneve 12 paragrafi 12.2 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, , si dhe neneve 9, 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 02. 2019, pas shqyrtimit te propozim vendimit te Kryetarit te Komunës miratoi këtë:

## V E N D I M PËR APROVIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE

### Neni 1

Me këtë Vendim , Kuvendi i Komunës së Lipjanit, APROVON, listën e projekteve kapitale për aplikim te donatorët dhe Ministrinë e ndryshme në Republikën e Kosovës.

### Neni 2

Lista e Projekteve kapitale, përfshin projektet si vijon:

1. Shtigjet e ecjes dhe shtigjet e bicikletave në Lipjan,
2. Vendosja e kioskave për shitje në Tregun e Gjelbër në Lipjan,
3. Rregullimi i shtratit të lumit Janjevka në Lipjan,
4. Asfaltimi i rrugës „Marie Shllaku“ nga Tranziti në Lipjan deri në Rufc të Ri,
5. Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen e Konjuhut dhe mbrapa Stadionit në Qytetin e Lipjanit,
6. Ndërtimi i shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit „Sitnica“,
7. Ndërtimi i urave mbi shtratin lumit „Sitnica“ në fshatrat Rufc dhe Kojskë,
8. Asfaltimi i rrugës së „Shkupit“, „Iliridës“ dhe rrugës së „Lumit“ në Gadime të Ulët,
9. Asfaltimi i rrugës Ribar i Vogël-Ribar i Madh,
10. Ndriqimi publik në Hallaq të Vogël, Rufc të Ri, Torinë, Poturovc, Qylagë dhe Magurë,

### Neni 3

Autorizohet, Kryetari i Komunës që duke u bazuar në dispozitat e këtij Vendimi, gjatë aplikimit për fonde të nxjerr Vendime të veçanta për aprovimin e secilit projekt nga lista e projekteve të cekura në nenin 2 të këtij Vendimi . Vendimet e veçanta nxirren në momentin e krijimit të kushteve për aplikim për projektin/projektet përkatëse .

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

#### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15Nr. 352 - 14816  
Lipjan, më 04. 03. 2019

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

